



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



PROCESVERBAL 11/2024

I Mbajtur në takimin e XI- të të rregulltë të KPF-së me datën **25.11.2024**, në ora **10⁰⁰** në Zyrën e takimeve te Kryetari i Komunës, nën kryesimin e Kryesuesit të KPF-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. XhavitZariqi, Kryesues;
2. Arian Imeri, Anëtar
3. Lumnije Morina, Anëtare;
4. Mimoza Pajaziti, Anëtare;
5. Lulzim Abazi, Anëtar;
6. Brahim Osmani, Anëtar;
7. Shqipe Jashari, Anëtare;
8. Hatixhe Bungu Qerimi, Anëtare;
9. Flamur Istrefi, Anëtar.

Drejtoret e drejtorive;

1. Afrim Llabjani – Drektor i Arsimit;
2. Sabri Murseli - Drektor i Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Përshëndetje të pranishëm, anëtarë të KPF-së, shoqëria civile, Drektor të drejtorive, pra po fillojmë me mbledhjen e XI-të të rregullt të KPF-së, besoi që materialin e keni marr me kohë dhe ju dëshiroi mirëseardhje në mbledhjen e KPF-së dhe propozojë këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KK-së;
4. Propozim – Vendim për Miratimin e Planit të veprimit kundër braktisjes mos regjistrimit në shkollë, 2024-2026;
5. Raporti i Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave dhe
6. Të ndryshme.

Pika shtesë:

1. Propozim – Vendim për Rishqyrtimi e Vendimit 01.Nr.90 i datës 27.09.2024;
2. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e palestrës së Xhudos dhe bartjen e pronësisë së pronës së Komunës në emër të Republikës së Kosovës, pjesën e ngastrës kadastrale me Nr. 569-1 dhe 570-1 Z.K. Ferizaj.

Pika 1

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Fillojmë me pikën e I-rë të rendit të ditës, Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së, të gjithë jemi prezent.

Pika 2

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Miratimi i rendit të ditës, a ka dikush të diskutoi rreth rendit të ditës,

Sabri Murseli – Propozoi një pikë shtesë për komitet, Rishqyrtimi i vendimit 01.Nr.90 i datës 27.09.2024 e cila është kthyer nga MAPL-ja vetëm për hipotekë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Po prap duhet me u kthy për kuvend?

Sabri Murseli – Po si pikë do të jetë e re në komitet dhe kuvend, unë e siguroi materialin që me shti në procesverbal të cilën e kam në email.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – A jeni që të kaloi në kuvend rendi i ditës me këtë pikë shtesë?, kush është që të kaloi pika e II-të?, faleminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e III-të të rendit të ditës.

Pika 3

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KPF-së; a ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar, si duket jo, a jeni që të kaloi procesverbalit i mbledhjes së kaluar?, faleminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e IV-të të rendit të ditës.

Pika 4

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Miratimin e Planit të veprimit kundër braktisjes mos regjistrimit në shkollë, 2024-2026;

Afrim Llabjani – Faleminderit kryesues, përvendosje për të gjithë të pranishmit, është një Propozim – Vendim për Miratimin e Planit të veprimit kundër braktisjes mos regjistrimit në shkollë, 2024-2026, një plan i cili është startuar nga Ministria e Arsimit, DKA-së që me startu një Qendër EU për çështjen e minoriteteve, ju e dini që kemi një numër të konsiderueshëm të nxënësve të minoriteteve, pastaj kemi edhe nga braktisja, po megjithatë është një plan që është shtu pothuajse në çdo komunë, e kemi pa të arsyeshme ta sjellim edhe ne në komitet dhe kuvend në mënyrë që të miratohet e pastaj t'i ndjekim procedurat tjera të diskutimit publik edhe deri te miratimi i tij, po propozoi që të kalon në komitet e pastaj në kuvend, nëse kemi çka të diskutojmë në kuvend.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faleminderit drejtor, a dëshiron dikush të diskutoi për këtë pikë?, a jeni që të kaloi në kuvend?, kush është që të kaloi pika e IV-të?, faliminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e V-të të rendit të ditës.

Pika 5

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Raporti i Komisionit për zgjedhjen e Kryetarëve të fshatrave, a ka dikush të diskutoi për këtë pikë?, urdhëro drejtor!

Sabri Murseli – Faleminderit kryesues, e këna ba një përbledhje të procesit të komisionit të fshatrave edhe që është i përbëm me tri lokacione që ka mbet pa u zgjedh, se janë ba disa përmirësimi rrreth rrugëve për me i shiti në proces, kanë mbet pa u përfshi disa Këshilla: Lloshkobare, Kosinë edhe Neredime e epërme, mirëpo në këtë raport është mbushur kriteri në çashtje 40, e kështu duhet me marr një vendim në kuvend sepse për shkak të pozicionit i kanë anuluar zgjedhjet në fshat, janë pranuar disa ankesa që nuk janë vlerësu zbulimi i atyre ankesave, e na ja mundësojmë përbillyjen e procesit të rregullt, e nëse ka pas vi zgjedhore me i klasifiku personat dhe me kundështimin e tyre në moment kur është përbillye vota na mujna me konsideru si proces të rregullt, kështu që u kanë e rrugës me nda Dubravën prej Zaskokit edhe Zaskok, Doganaj dhe Dubravë, është kanë e rrugës së kërkësës të komunitetit që jetojnë atje në atë zonë, në këtë janë plotësuar 40, ndërsa kanë mbet edhe pa u përfshi Lloshkobare edhe Neredime e epërme, kështu duhet me marr një vendim të këtyre lokacioneve që kanë numër më të vogël të banorëve me i ba nja dhe me e rishpallë zgjedhjen në ato dy lokacione dhe me plotësu numrin 40 ose me marr një vendim të veçantë në kuvend, për me i zgjedhë kryetarët e këshillave

dhe se mënyra e pagesës sipas udhëzimit administrativ nuk mundet me i pagua mbi 40 Kryetar të këshillave, e kam përgatit një raport nga Drejtoria e administratës dhe e kam përgatit listën, janë edhe disa ankesa që duhet me i shqyrtu p.sh në zonën III mos gabofsha është një ankesë që kryetari i zgjedhur aktual ka aplikuar edhe në zonë tjetër, kështu që duhet me vlerësu sepse këtu është pranu indikacioni, e tash me u zgjedhë në një lokacion tjetër nuk ka logjikë, por janë do vendime që nuk janë lokacione fare dhe që duhet me i marr do vendime ligjeshmërin e atij procesi sepse ka qenë e regjistruar, në kuwend do t'i bie edhe kopjen e ankesave dhe do t'i shqyrtojmë të gjitha, faleminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faleminderit a ka dikush të diskutoi?,

Brahim Osmani - Faleminderit, përshëndetje për të gjithë, në kuadër të raporteve nuk i kena marr me kohë dhe nuk e di kush e ka ba këtë raport, pra lokacioni nuk është i njejtë dhe se ju më keni akuzuar se pse e ke vonuar procesin e zgjedhjeve nëpër fshatra dhe se ai ka dhanë 5 muaj me parë dorëheqje dhe ky proces ka përfundu dhe Planin e punës të këtij procesi e ka ndryshu kryetari, e kam thanë edhe në kuwend, e ka ndryshu prej zyrës së vet, tamam don me shku puna dhe të përfundoi një proces dhe me shku tamam me rregullë, por në momentin e punës e kemi pru para komisionit ka ndryshu, çdo gjë ka ndryshu, kushdo që ka votu dikund tjetër dhe është kryetar, kjo dihet që nuk është kryetar dhe nuk e lejon edhe ligji, pra nuk jemi ngut si komision se kush është duke votu në këtë vend, për shkak se kena qenë të ndar, një pjesë nuk e kanë ditë kush është duke u votu këtu e kush është zgjedhë atje, por e para raporti nuk është ba, e dyta që 5 muaj nuk është thirrë anëtarë për tu zavendësu, se di kush e ka ba këtë Raport, zgjedhjet në Neredime kanë pas me u ba sipas Planit të Punës së Kuvendit, e ka ndryshu për shkak se asistenti dhe një zyrtar që punon në zyrën e kryetarit është ba kryetari i degës, ka ndryshu prej kryetarit, e jo prej komisionit, na si komision i kena pas votat, po edhe një herë, unë jam kundër të këtij raporti, kështu që kur vjen raporti çfado komisioni që vjenë e shqyrton, e që komisioni që 5 muaj nuk është mbledhë për me pru raport në kuwend, këtë e di, as nuk jemi mbledh na, as nuk është ardhe anëtarë që e kemi zgjedh na dhe as nuk ka pas thirrje prej Drejtorisë së administratës për me u mbledh, as nuk ka mundësi drejtoresha për me sjellë këtë raport, këtë duhet me pru komisioni dhe çdo raport që vjenë jena kundër dhe duhet me ndryshu edhe procesin e zgjedhjeve, si p.sh Kosina dhe Lloshkobarja në veti e ka atë person përgjegjës apo atë kryetar për atë pjesë që duhet, p.sh në Neredime nuk di shka keni ba për me e ndryshu, asistentin e kryetarit të komunës në atë pjesë me ba Kryetar të degës, faleminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faleminderit a ka dikush të diskutoi? Urdhëro Flamur.

Flamur Istrefi – Faleminderit Kryesues, Drejtor sa herë që i bini pikat, asnjëherë nuk i bini pikat të plota, herën e kalume listën e pronave nuk e keni pru hiç, që janë ba dallavere në disa prona p.sh në Zaskok që ka kalu ma herët, nuk është në rregullë Drejtor, sot Raporti duhet me u

diskutu, nuk kemi Raport qysh me diskutu, krejt pikat sa herë që vijnë janë mangët, e ki krejt kohën në dispozicion që me i ba gati me na sjellë, unë nuk po di se si proces i suksesshëm që ende nuk ka përfundu, e që një vjet ka marr kohë, planifikimi ka pas me u ba për një muaj, ka shku një vit, po donë me marr vendim kuvendi, çfar vendimi me marr kuvendi kur t'i e ki edhe udhëzimin administrativ edhe rregulloren që asnjanë nuk ka kalu, keni pas me kry punën e nuk e keni kry, e tash po donë me kalu në kuvend, na nuk e dimë se nëse na vjen raporti në kuvend qat ditë, na në kuvend me diskutu.

Sabri Murseli – Raporti me numër të votave në bazë të procesverbalit që u sjellë nga komisioni në Drejtorinë e administratës, nuk ka pas ndonjë analizë të veçantë për to, sipas procesverbalit në teren kanë dal numri i votave, numri i telefonit të personit që është zgjedh, nuk ka diçka tjeter në këtë raport, pjesa e ankesave në follder janë të pa shqyrtime përpos që jemi mbledhë se nuk ka qenë detyra e jem por e komisionit, kështu që je kanë t'i, kështu që mua mi gjuni topat këtu e që unë mas pakti kam faj unë, se unë nuk jam në proces këtu, prej asaj dite prej si u kry zgjedhja ma nuk jam marr me këtë proces, vetëm si pikë e mora këtë me marr në komitet, se edhe sot nuk e kisha marr me komision, se komisioni u kanë dashtë me ju përgjigj, kryetar të komisionit nuk këna pas, i këna nda në tri grupe, në tri rrugë të ndryshme i këna pas, nuk këna pas kryetar të komisionit.

Brahim Osmani – Unë e di që nuk ki pas faj t'i, po më vjenë keq me ta thanë kështu, se para se mu zgjedhë komisioni ke qenë t'i prej ekzekutivit, nënkyetarit dhe që ki thanë që unë jam Kryetar i komisionit kështu ka qenë, sa i përket procesverbalit apo raportit të komisionit për sa janë votat te kryetarët e zyreve lokale, ka mundësi të jenë të vërteta, por unë nuk po shohë raport, e raportin përfundimtar duhet me ja pru kuvendit prej komisionit, edhe se kam thanë komisionit që nuk ka të drejtë me i kalu 40 zona, për me u zgjedhë, duhet me ba një organizim të mirë, u ba organizimi dhe e keni ndryshu pa marr vendim komisioni, dhe si anëtar i komisionit unë e kam marr vesh simbas postimeve në facebook, as nuk e kam ditë as qysh e keni nda, zona në qytet nuk është kanë me u ba hiç, kryetari i ka ndryshu, i ka ba 40 zona, Neredime ka pas me u ba veç nja, kryetari e ka ndryshu për arsy se mu ba asistenti i tij, me u ba kryetari i zonës së Neredimës, ky nuk është raport, por është procesverbal simbas votave, ok, na kuvendit mujna me ja pru votat me procesverbal, por nuk është përfundimtar, por me u kthy komisioni prap me i shqyrtu ankesat, nuk e ka pa të arsyeshme me i ndryshu, për shkak që ka pas ankesa edhe gjatë kohës së votava nëpër fshatra, mujnë me i pas 300 apo 400 vota por nuk është raport përfundimtar edhe unë nuk them që t'i i ki krejt fajet.

Sabri Murseli – Mirë është, se kjo është vetëm një informatë për kuvend.

Arian Imeri – Edhe unë nuk pajtona me komision, duhet me na ardhë një Raport përfundimtar për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave d.m.th. na si proces duhet me përfundu dhe nuk duhet me ankesa me u shqyrtu në kuvend, ju e keni Udhëzimin administrativ, e keni ligjin dhe kushdo që i rregullon këtë proces, komisioni ka me udhëheq këtë komision, në bazë të direktivave ligjore që i

ka dhe në bazë të saj e bjen në përfundim edhe ankesat dhe të gjitha ndryshimet dhe në fund bjen një Raport përfundimtar në kuvend, aprovohet dhe përfundon si proces, e jo me ankesa të pa shqyrtume me ardhë në kuvend, faleminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faleminderit Arian.

Sabri Murseli – Na si komision tash po hy te zona 1, e këna mbyll procesin, e mbas përfundimit të procesit e këna pa që i njëjti person ka apliku edhe në Jezerc dhe u zgjedh kryetar në zonën 1, e na si komision na me i shpallë prap zgjedhjet simbas Planit administrativ nuk shkrun kurr kund, është një komision i ankesave dhe simbas komisionit të ankesave me na obligu neve me i rishpall zgjedhjet, pra simbas punës tonë si p.sh te zona jem ka pas njerëz, gjysa e rrugës së Varoshit, ka pas këshill e gjysa e popullatës ka dal në anën tem dhe se kur nuk ish përfundu si proces, ose ki raste tjera që jetojnë në fshatra dhe prej fshatrave kanë shku në qytet dhe unë kisha propozu që të mblidhet komisioni dhe t'i shqyrtojmë këto dhe po e bajmë një raport të plotë me të gjitha.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Edhe unë mendoi kështu, se komisioni ka me e zgjedhë këtë punë dhe me sjellë një Raport përfundimtar, nëse duhet me u legjitim në kuvend, unë nuk e di pse duhet me ardhë, pra nëse duhet me ardhë qata kryetar që janë zgjedh, me u legjitim me votë kundër, duhet me ardh pa tjetër për ndryshe ata mbasi janë zgjedhë, kuvendi nuk ka njëfarë pengese me i aprovu, deri tash a janë pagu, apo nuk janë pagu?.

Sabri Murseli – Deri tash nuk janë pagu.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Nuk kanë me u pagu mbasi e kryejnë mandatin, nuk kanë imunitet.

Sabri Murseli – Për me u pagu një Kryetar të fshatit duhet me i mbajt 6 mbledhje në vit, duhet me i mbajt procesverbalet se çka janë diskutu temat edhe me e arsyetu pagesën e vet, çfar kërkesa janë marr, se kryetari i këshillit nuk i njeh banorët, i njeh vetëm këshillat dhe këta janë mësu me kërkesa e procesverbale nuk mbajnë, asnjë për këtë arsyen kanë pas pengesë në pagesa dhe telashe në pagesa, pra e prebatitim ma mirë dhe e sjellim në kuvend.

Lumnije Morina – Për shkak të zgjedhjes së komisionit për zgjedhjen e Kryetarit nëpër fshatra, nuk ka drejtë një qytetar tjetër me ardhë me i shqyrtu ankesat.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – A jeni me shty për dhjetor këtë pikë?, faliminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën të ndryshme.

Pika 6

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Të ndryshme, a ka dikush të diskutoj për pikën e 6-të?

Sabri Murseli – Edhe Rishqyrtimi i Vendimit ka qenë vetëm për hipotekë, që është kthyer prej ministrisë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Rishqyrtimi e Vendimit 01.Nr.90 i datës 27.09.2024, a jeni që këtë pikë shtesë të kaloi për kuvend?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon,

Sabri Murseli – Pëlqimi ka qenë prej bankës paraprakisht, po ministria tash e ka kriju një standard të ri dhe është hera e parë që ka kërku dhe kështu mirë që ka kërku, se në të ardhmen nuk do të ketë kësi raste, pa ardhë prej bankës lirimi i hipotekës nuk e zhvillojmë procedurën, kështu që është mirë t'i shikojmë lirimin e hipotekave, vetëm për hipotekë kurrgja tjetër nuk ka.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Është që të kaloi në kuvend?, faleminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon edhe fillojmë me pikën e rendit të ditës në të ndryshme.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – A ka najkush të diskutoj diçka?, nuk ka, atëherë me kaq po e myllim mbledhjen e KPF-së, faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësja

Zafarshiku

Zyliha Tafarshiku



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi